

VENDIM
Nr. 46, datë 31.1.2024

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 456, DATË 29.6.2022,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E KUSHTEVE PËR
VENDOSJEN E DETYRIMIT TË SHËRBIMIT PUBLIK, QË DO TË ZBATOHEN
NDAJ TË LICENCUARVE NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE, TË
CILËT USHTROJNË AKTIVITETIN E PRODHIMIT, TRANSMETIMIT,
SHPËRNDARJES DHE FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 47, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në tekstin “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të miratuar me vendimin nr. 456, datë 29.6.2022, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në nenin 3, të pjesës I, shtohen pikat 5 dhe 6, me këtë përmbajtje:

“5. Në këtë vendim, fjalët “instrument financiar” nënkuptojnë marrëveshje për faturimin reciprok të diferencës midis çmimit klerues për njësi kohore të tregut (të ditës në avancë ose tregun brenda së njëjtës ditë) për ditën e lëvrimit me çmimin e parashikuar në marrëveshjen e lidhur midis palëve, të cilat sigurojnë pjesëmarrësit ndaj luhatjeve të mundshme të çmimit të energjisë elektrike në treg.

6. Në këtë vendim, fjalët “treg likuid” nënkuptojnë tregun që përmbush kriteret për gatishmërinë e tij, bazuar në vlerësimin e bërë nga ERE-ja, sipas përcaktimeve të nenit 30, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e burimeve të rinovueshme.”.

2. Në nenin 5, të pjesës II, bëhen këto shtesa:

a) Në pikën 3, pas fjalëve “...të kryejë transaksione shitblerjeje energjie në tregun e lirë...” shtohen “...përfshirë tregun e ditës në avancë ose tregun brenda së njëjtës ditë...”;

b) Në pikën 7 bëhen këto shtesa:

i. Pas fjalëve “...nga burimet e rinovueshme të energjisë në periudhat pararendëse...” shtohen “...sipas parashikimeve të nenit 12, të këtyre kushteve,...”;

ii. Pas fjalëve “...me çmimin e blerjes së energjisë së prodhuesve me përparësi hidrike...” shtohen “...dhe më tej tregtohet në tregun e lirë ose të ditës në avancë ose tregun brenda së njëjtës ditë...”.

3. Në nenin 12, të pjesës II, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në pikën 3 bëhen këto shtesa:

i. Pas fjalëve “...krijimin e operatorit të energjisë së rinovueshme dhe krijimin e tregut...” shtohen “...likuid të energjisë elektrike...”;

ii. Në fund të kësaj pike shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Çmimi i blerjes së energjisë nga tepricat e burimeve të rinovueshme për furnizimin e klientëve të furnizuesit publik në treg të lirë, duke filluar nga 1 janari 2024 është çmimi i blerjes së energjisë së prodhuesve me përparësi hidrike, ndërsa çmimi i shitjes për njësi miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë.”.

b) Në pikën 4, dy fjalitë e para ndryshohen, si më poshtë vijon:

“Në rast të tepricave të krijuara nga prodhimi i burimeve të rinovueshme të energjisë, ato fillimisht do të tregtohen për nevoja të furnizimit të klientëve të shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë, ndërsa sasia e mbetur do të depozitohet te shoqëria publike e prodhimit, për t’u përdorur për nevoja të furnizimit të klientëve universalë. Sasitë rakordohen me bazë mujore dhe

shkëmbehen gjatë vitit për mbulimin e humbjeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe nevojave të shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë, bazuar në sasinë dhe programet e kërkuara nga furnizuesi i tregut të lirë, për të cilat është rënë dakord ndërmjet palëve.”.

c) Në pikën 5 bëhen këto shtesa:

i. Pas fjalëve “...ta sigurojë këtë energji në treg të parregulluar...” shtohen “..., kryesisht ose...”;
ii. Pas fjalëve “...të miratuar me vendim të Entit Rregullator të Energjisë...” shtohen “..., të cilat mund të përfshijnë edhe përdorimin e instrumenteve financiare.”.

4. Në nenin 12, të pjesës II, shtohet neni 12/1, “Mbulimi i humbjeve në transmetim”, me këtë përmbajtje:

“Neni 12/1

Mbulimi i humbjeve në transmetim

Operatori i Sistemit të Transmetimit siguron energjinë për mbulimin e humbjeve në tregun e parregulluar të ditës në avancë ose tregun brenda së njëjtës ditë apo nëpërmjet procedurave, sipas parashikimeve të nenit 62, ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të cilat mund të përfshijnë edhe përdorimin e instrumenteve financiare.”.

II. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama